

PRESS RELEASE TIFF 2012

TIFF do të hapet mbrëmjen e 23 nëntorit me Programin Special “**Reflecting Albania**”, program që prej dhjetë vjetësh në festival i kushtohet filmave të prodhuar nga të huajt për Shqipërinë. Do të jetë filmi dokumentar “

La Nave Dolce

”, bashkëprodhim italo-shqiptar, fitues i çmimit “

Francesco Pasinetti

”, si filmi më i mirë i prezantuar në Festivalin e fundit në Venecia, që do hapë siparin e TIFF 2012 në Kinema Millennium. Do të jenë prezent në premierën ballkanike të këtij filmi regjisori

Daniele Vicari

, skenaristja

Antonella Gaetta

dhe

Kledi Kadiu

, dëshmitar okular në udhëtimin e anijes me sheqer.

Konkurrimi në TIFF do të fillojë në 24 nëntor në **Imperial Cinemas-Sheraton** me kategorinë e **FILMAVE ME METRAZH TË GJATË**

deri në datë 27 nëntor, ditë kur do të shpallen fituesit në këtë kategori me 8 filma. Juria ndërkombëtare që do të vlerësojë filmat e kësaj kategorie përbëhet nga:

Vladimir Blazevski

, regjisor (Maqedoni), fitues i TIFF 2011 me filmin “Punk’s Not Dead”;

Marian Tutui

, murator e filmologjist në Cinematekën e Rumanisë;

Massimo Forleo

, Drejtor Artistik në RAI.

Në datën **28 nëntor** është vendosur të projektojmë vetëm **FILMAT NË SHQIP**, që bëjnë pjesë në këtë kategori prej 25 filmash dhe fituesit do shpallen në mbrëmjen e 28 nëntorit nga një juri e përbërë nga: **Ro**

bert Aliaj Dragot

, artist:

Koloreto Cukali

, skenarist;

Kast Hasa

, regjisor, fitues i kësaj kategorie në TIFF 2011.

Gjithashtu në kuadrin e festës kombëtare të Pavarësisë kemi menduar të shfaqim për herë të parë për publikun, filmin rumun të vitit 1929 “Hajducii”, ku protagonist kryesor është artisti i njohur **Kristaq Antoniu**. Ky projektion special do të mundësohet në bashkëpunim me Arkivin Qëndror Shtetëror të Filmit dhe do shfaqet në sallën e AQSHF-së.

Festivali do të vazhdojë me konkurrimin në kategorinë e **FILMAVE TË SHKURTËR** me 53 filma në këtë kategori deri në datën 2 dhjetor kur do të shpallen fituesit dhe do të mbyllet TIFF 2012.

Kjo juri përbëhet nga

Blerta Zeqiri

, regjisore (Kosovë), fituese në Sundance dhe Sarajevo Film Festival;

Elektra Venaki

, studiuese dhe lektore (Greqi);

Stefania Casini

, regjisore (Itali).

Në kuadrin e Programit Special dhe të 100 vjetorit të lindjes së **Michelangelo Antonioni** do të kemi tre shfaqje filmash të regjisorit të madh Italian shoqëruar me një film dokumentar të bashkëshortes së tij,

Enrica Antonioni

, e cila do të jetë prezente në Tiranë së bashku me producentin e Antonionit,

Amedeo Pagani

.

Në kuadrin rajonal do të shfaqim programin special “**RUMANIA – RRYMA E RE**”, si një nga kinematë më të mira në botë me dy filma fitues në Festivalin e Kanës.

Këtë program si dhe seminarin me titull “**KINEMAJA NË/DHE TOTALITARIZMI**” do ta kurojë
Z. **Marian**

Tutui

Profesor në Hyperion University, kurator në Arkivin e Filmit Rumun në bashkëpunim me Znj. Eriona Vyshka dhe AQSHF.

Përveç tij, gjatë 10 ditëve të festivalit jubilar të TIFF do të mbahen edhe disa workshop-e si:

“**ALBANIA FILM COMMISSION**”, që trajton problemin e bashkëprodhimit midis vendeve të ndryshme duke u bazuar në ndërthurjen e interesave kinematografike me ato të promovimit territorial dhe turistik, avantazhet në drejtim të punësimit si edhe benefitet e drejtpërdrejta financiare. Roli i pushtetit vendor dhe atij qendror dhe koordinimi i institucioneve midis tyre.

“**48HOUR FILM PROJECT**”, që trajton përfshirjen e të rinjve në prodhimin e filmave me buxhet të ulët.

“**TË DREJTAT LGBT DHE KINEMAJA**”, ku duke marrë shkak nga transmetimi i një filmi me këtë temë, do të diskutohet kinemaja si mjet i mbrojtjes së të drejtave të komunitetit LGBT.

Massimiliano Nardulli, Drejtor i Seleksionimit dhe Programimit në **Brest Film Festival**, Francë, do të sjellë gjatë ditëve të konkurrimit të filmave të shkurtër një program me **filmat më të mirë të shkurtër evropianë** të dy viteve të fundit.

Elektra Venaki, themeluese e sitit AltCine.com dedikuar kinemasë ballkanike si dhe drejtuese e Festivalit të parë OnLine të Filmit të Shkurtër në Ballkan, do paraqesë para publikut një program special me **filma të shkurtër ballkanikë** të viteve të fundit.

Si çdo vit, që nga krijimi i tij, TIFF do të japë edhe **Çmimin e Medias** nëpërmjet jurisë së përbërë nga **Maks Velo**,
artist;

Rajmonda Nelku

, Pedagoge e Gazetarisë në UT;

Ridvan Peshkëpia

, studiues, PhD në shkencat politike.

Këtij Çmimi i shtohet edhe **Çmimi i Publikut**, që pas suksesit të vitit të do të përcillet nëpërmjet votimit në internet.

Me projeksionin special në Kinema Millennium të filmit italian “ [È Stato Il Figlio](#) ” nga **Daniele Cipri**, fitues i çmimit si skenari më i mirë në konkurrimin ndërkombëtar të festivalit të fundit në Venecia 2012 dhe me praninë e regjisorit në këtë premierë ballkanike të filmit TIFF 2012 e mbyll për këtë vit edicionin e dhjetë maratonë të tij për të lënë takim në edicionin e ardhshëm.

Për më shumë hollësi rreth këtij aktiviteti, që feston këtë vit edicionin e tij të 10-të, lexoni **Programin Ditor të TIFF 2012** dhe NEWS TIFF 2012

http://www.tiranafilmfest.com/images/stories/tiff2012/DAILY_PROGRAM_TIFF_2012.pdf